

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nënshkruan aderimin e AMF-së në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbiqëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar – Maj 2022

Zhvillime të tjera

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë
- AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për regjistrimin e agentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në një vend anëtar të BE-së”

Publikime Profesionale

- BIS Prezantohet “Raporti Ekonomik Vjetor, 2022”
- OECD Publikohet “Vështrimi Ekonomik – Qershor 2022”

Informacione Ndërkombëtare

Bosnje-Hercegovinë
Republika Çeke

Hungari
Republika Sllovake

Kroaci
Rumani

Poloni
Serbi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nëshkruan aderimin e AMF-së në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)



16 qershor - Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nëshkruan aderimin e AMF-së në memorandumin shumëpalësh të IAIS

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, z. Ervin Mete nëshkroi aderimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Memorandumin Shumëpalësh të Bashkëpunimit të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). Ceremonia e nënshkrimit u realizua me rastin e Takimeve të Komiteteve dhe Seminarit Global të IAIS dhe në të morën pjesë Kryetarja e Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, Dr. Vicky Saporta, Sekretari i Përgjithshëm, z. Jonathan Dixon, si edhe drejtues të tjerë të IAIS dhe AMF.

Aderimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve. AMF bëhet pjesë e një grupi prej 77 vendesh nënshkruese të MMoU-së, pasi ka realizuar një proces rigoroz verifikimi të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me standardet ndërkombëtare të IAIS.

Kryetarja e Komitetit Ekzekutiv të IAIS, Dr. Vicky Saporta i uroi mirëseardhjen Shqipërisë në grupin e vendeve nënshkruese të Memorandumit. Ajo vlerësoi hapat e ndërmarra nga Autoriteti deri në anëtarësimin në Memorandum dhe u shpreh se kjo do t'i shërbejë AMF për një realizuar një bashkëpunim më të ngushtë me mbikëqyrësit e tjerë.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete e cilësoi një arritje për Autoritetin aderimin në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të IAIS. Z. Mete konsideroi se aderimi në MMoU do të jetë ndihmesë për shkëmbimin e informacionit, për një mbikëqyrje më efektive të grupeve ndërkufitare të sigurimeve. Ai tha gjithashtu se Autoriteti në bashkëpunim me IAIS do të përmbyllë vlerësimin e Parimeve Themelore Ndërkombëtare në sigurime (ICP), për të siguruar një avancim të mëtejshëm të praktikave mbikëqyrëse me standardet ndërkombëtare.

Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit të IAIS përfaqëson një kuadër global përputhshmërie dhe konfidencialiteti, që i hap rrugën bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve të tregut të sigurimeve, me qëllim garantimin e stabilitetit në tregjet financiare globale.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete theksoi se AMF në bashkëpunim me IAIS do të përmbyllë vlerësimin e Parimeve Themelore Ndërkombëtare në sigurime (ICP), për të siguruar një avancim të mëtejshëm të praktikave mbikëqyrëse me standardet ndërkombëtare.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Maj 2022

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-maj 2022 kapën vlerën 7,771 milionë lekë, ose 10.87% më shumë se në janar-maj 2021. Gjatë periudhës janar-maj 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 445,558 me një rritje prej 23.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.36% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës realizuan 7.50% të vëllimit total të primeve. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.95% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 57.05% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-maj 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,709 milionë lekë, ose 13.83% më pak se në periudhën janar-maj 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-maj 2022 kapën vlerën 1,784 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 4.11% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Maj 2022 (Në %)

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-maj 2022 kapën vlerën 1,784 milionë lekë.



ZHVILLIME TË TJERA

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë



9 qershor - Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor të AMF-së në Kuvendin e Shqipërisë

Përgjatë muajve të parë të vitit 2022, tregu i sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare kanë vijuar trendin rritës, ndërsa konstatohet një rënie e lehtë e aseteve të fondeve të investimit, ku përsëri ekspozimi i tyre ndaj luhatshmërisë së tregjeve ndërkombëtare mbetet i kufizuar.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete prezantoi më 9 qershor 2022, në seancë plenare në Kuvendin e Shqipërisë, raportin mbi veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2021. Z. Mete bëri një pasqyrim të ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, të zhvillimeve kryesore përgjatë vitit të kaluar, si edhe parashtrori objektivat për periudhën në vazhdim.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se tregjet financiare u shfaqën rezistentë pas disa ngjarjeve të paprecedenta të njëpasnjëshme, siç ishte tërmeti, pandemia dhe së fundmi konflikti mes Rusisë dhe Ukrainës. Ai theksoi se edhe përgjatë muajve të parë të vitit 2022, tregu i sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare kanë vijuar trendin rritës, ndërsa konstatohet një rënie e lehtë e aseteve të fondeve të investimit, ku përsëri ekspozimi i tyre ndaj luhatshmërisë së tregjeve ndërkombëtare mbetet i kufizuar. Autoriteti po monitoron situatën në vijimësi dhe ka miratuar një udhëzim të posaçëm ku u kërkohet shoqërive administruese të tregojnë kujdes të shtuar dhe të marrin një sërë masash.

Z. Mete u shpreh se riformatimi i pjesës kryesore të ligjeve dhe rregulloreve të tregjeve nën mbikëqyrje, të përafuara me Direktivat Evropiane, ka dhënë efekte konkrete. Ai përmendi ligjin për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit që ka rritur vlerën e dëmshpërblimit, ka reduktuar kohën e trajtimit dhe pagesës së dëmeve, ka adresuar problematikat ndër vite me Fondin e Kompensimit, ka ulur ndjeshëm komisionet për ndërmjetësit dhe shpenzimet e marrjes në sigurim, si edhe ka mundësuar aplikimin për herë të parë edhe në Shqipëri të Raportit Evropian të Aksidenteve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë

... vijon

Ligji për sipërmarrjet e investimeve kolektive ka shtuar mbrojtjen e investitorit, ka rritur kërkesat për kapital për shoqëritë, ka mundësuar krijimin e formave të reja të fondeve të investimit, si edhe ka parashikuar për herë të parë marketimin dhe shitjen në Shqipëri të fondeve të licencuara në vendet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ligji për tregjet e kapitalit ka vendosur standarde më të larta licencimi dhe mbikëqyrjeje për subjektet, ka krijuar për herë të parë mundësinë e ofrimit të shërbimeve të reja të investimit, të ndërlidhjes së drejtpërdrejtë me tregjet globale, si edhe ka zgjeruar gamën e instrumenteve financiare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv përmendi aderimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Memorandumin Shumëpalësh të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) si një zhvillim të rëndësishëm, në funksion të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mbikëqyrësve në tregun e sigurimeve. Kjo u realizua pas një procesi rigoroz të verifikimit të përputhshmërisë së bazës ligjore dhe rregullatore me standardet ndërkombëtare të IAIS. Gjithashtu, në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe me asistencën e Bankës Botërore, Autoriteti po realizon një vlerësim të progresit të bërë në lidhje me Parimet Themelore Ndërkombëtare në sigurime.

Në fund të fjalës së tij, z. Mete theksoi se Autoriteti do të përqendrohet në vijim të miratimi i pjesës së mbetur të akteve nënligjore, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe avancimi me standardet më të mira ndërkombëtare, finalizimi i strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, si edhe monitorimi i kujdesshëm i treguesve kryesorë financiarë me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe shëndetshmërisë së subjekteve në mbikëqyrje.

Autoriteti do të përqendrohet në vijim të miratimi i pjesës së mbetur të akteve nënligjore, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve mbikëqyrëse dhe avancimi me standardet më të mira ndërkombëtare.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në një vend anëtar të BE-së”



Projektregullorja gjendet në linkun: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=83>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ka hartuar projektregulloren “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në një vend anëtar të BE-së”.

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun: <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=83>

Publikohet “Raporti Ekonomik Vjetor, 2022” i BIS

No respite



Raporti Ekonomik Vjetor 2022 i publikuar nga BIS (Bank for International Settlement) fillon me një editorial ku cilësohet se ekonomia botërore nuk po gjen prehje.

Dy vjet më parë, bota u trondit nga fillimi i pandemisë, dhe kriza e madhe shëndetësore u shndërrua në një krizë dërrmuese ekonomike. Ndërkohë që dridhjet e mëvonshme të pandemisë ende janë të dukshme, dy goditje të reja tronditën botën gjatë këtij viti: rigjallërimi i papritur i inflacionit dhe lufta tragjike në Ukrainë. Raporti Vjetor Ekonomik i vitit të kaluar (AER) ngriti perspektivën e një pandemit me gunga; gungat kanë rezultuar të jenë një goditje e dyfishtë.

Këto ngjarje të trazuara me siguri do të kenë pasoja të mëdha. A jemi ndoshta dëshmitarë të një ndryshimi regjimi, nga një regjim me inflacion të ulët në një regjim me inflacion të lartë? A flirton ekonomia globale me stagflacionin? Dhe a po shohim shenja të një fundi të epokës së globalizimit të pas Luftës së Dytë Botërore? Ndërkohë, kriptouniversi është në trazira, duke na kujtuar se ka zhvillime të rëndësishme në sistemin monetar, të cilat nuk mund t'i neglizhojmë.

Në frontin makro, politika po përballet me sfida të frikshme. Në disa mënyra, ato nuk janë të reja; por në të tjerat, ato janë unike. Siç tha Mark Twain, "Historia nuk përsëritet, por shpesh rimon". Ekonomia botërore përjetoj stagflacion në vitet 1970, pas një zhvendosjeje nga një regjim me inflacion të ulët. Elementi i ri është se, në sfondin e normave të interesit historikisht të ulëta, nivelet e borxhit – privat dhe publik – nuk kanë qenë kurrë aq të larta. Kjo nuk është aspak e parëndësishme. Për më tepër, sistemi monetar dhe financiar është në vuajtjet e revolucionit dixhital.

https://www.bis.org/publ/arpdf/ar2022e_ov.htm

Publikohet “Raporti Ekonomik Vjetor, 2022” i BIS

... Vijon

Raporti Vjetor Ekonomik 2022 i trajton këto çështje, se çfarë ndodhi gjatë vitit në shqyrtim dhe cilat janë rreziqet përpara? Çfarë mund të bëjë politika? Dhe ku po shkon sistemi monetar ndërsa vazhdon revolucioni dixhital? Cili vizion duhet të drejtojë politikën? Raporti Vjetor Ekonomik 2022 i BIS ka tre kapituj kryesore: (i) Sfida të vjetra, tronditje të reja; (ii) Inflacioni: Një vështrim në thellësi; (iii) Sistemi monetar i së ardhmes.

...

Kapitulli III. Sistemi monetar i ardhshëm

Kapitulli argumenton se sistemi monetar dhe financiar i së ardhmes duhet të kombinojë karakteristikat dixhitale me besimin tek bankat qendrore.

Pikat kryesore:

- Një shpërthim inovacioni krijues është duke u zhvilluar me monedhat ashtu edhe në sistemin e pagesave, duke hapur mundësitë e një sistemi monetar dixhital të ardhshëm që përshtatet vazhdimisht për t'i shërbyer interesit publik.
- Të metat strukturore e bëjnë universin e kriptomonedhave të papërshtatshëm si bazë për një sistem monetar: atij i mungon një ancorë nominale e qëndrueshme, ndërsa kufizimet në shkallëzueshmërinë e tij sjellin fragmentim. Ndryshe nga tregimi i decentralizuar, krypto-t shpesh mbështeten në ndërmjetës të parregulluar, që paraqesin rreziqe financiare.
- Një sistem i bazuar në paranë e bankës qendrore ofron një bazë më të fortë për inovacion, duke siguruar që shërbimet të jenë të qëndrueshme dhe ndërvepruese, brenda dhe jashtë kufijve. Një sistem i tillë mund të mbështesë një rreth besimi dhe përshtatshmërie, nëpërmjet efekteve të rrjetit.
- Aftësitë e reja si programueshmëria, kompozueshmëria dhe tokenizimi nuk janë pronë e kriptove, por mund të ndërtohen mbi monedhat dixhitale të bankës qendrore (CBDC), sistemeve të pagesave të shpejta dhe arkitekturës së të dhënave të ndërlidhura.



<https://www.oecd.org/economic-outlook/>

Bota po paguan një çmim të rëndë për luftën e Rusisë në Ukrainë. Kjo është një fatkeqësi humanitare, duke vrrarë mijëra dhe duke detyruar miliona të largohen nga shtëpitë e tyre. Lufta ka shkaktuar edhe krizë të kostos së jetesës, duke prekur njerëzit në mbarë botën. E bashkëshoqëruar edhe me politikën zero COVID-19 të Kinës, lufta e ka vendosur ekonominë globale në një kurs të rritjes më të ngadaltë dhe rritjes së inflacionit - një situatë që nuk është parë që nga vitet 1970. Rritja e inflacionit, e nxitur kryesisht nga rritjet e mëdha të çmimit të energjisë dhe ushqimit, po shkakton vështirësi për njerëzit me të ardhura të ulëta dhe po rrit rreziqe serioze për sigurinë ushqimore në ekonomitë më të varfra të botës. Pikat kryesore të raportit janë:

- Lufta po ngadalëson rimëkëmbjen;
- Presionet inflacioniste janë intensifikuar;
- Kriza e kostos së jetesës do të shkaktojë vështirësi dhe rrezikon urinë.

Lufta po ngadalëson rimëkëmbjen

Para luftës, ekonomia botërore ishte në rrugën e duhur për një rikuperim të fortë, megjithëse të pabarabartë, nga COVID-19. Konflikti në Ukrainë dhe ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit të përkeqësuar nga mbylljet në Kinë për shkak të politikës zero-COVID, po i japin një goditje të rëndë rimëkëmbjes. Rritja globale e Prodhimit të Brendshëm Bruto tani parashikohet të ngadalësohet ndjeshëm këtë vit, në rreth 3%, dhe të mbetet me një ritëm të ngjashëm edhe gjatë vitit 2023. Ky është shumë më i ulët se ritmi i rimëkëmbjes së parashikuar dhjetorin e kaluar.

Rritja pritet të jetë dukshëm më e dobët se sa pritej në pothuajse të gjitha ekonomitë. Shumë nga vendet më të goditura janë në Evropë, e cila është shumë e ekspozuar ndaj luftës përmes importeve të energjisë dhe flukseve të refugjatëve.

Vendet në mbarë botën po goditen nga çmimet më të larta të mallrave, të cilat shtojnë presionet inflacioniste dhe frenojnë të ardhurat dhe shpenzimet reale, duke e dobësuar më tej rimëkëmbjen.

Ky ngadalësim i rritjes është një çmim i luftës, i cili do të paguhet përmes të ardhurave më të ulëta dhe më pak mundësi punësimi.



Presionet inflacioniste janë intensifikuar

Lufta në Ukrainë ka shuar shpresat për një fund të shpejtë të inflacionit në rritje nga pengesat e furnizimit të lidhura me COVID-19, të vërejtura në të gjithë ekonominë globale gjatë vitit 2021 dhe fillimit të 2022.

Çmimet e larta të ushqimeve dhe energjisë dhe përkeqësimi i vazhdueshëm i problemeve të zinxhirit të furnizimit nënkuptojnë se inflacioni i çmimeve të konsumit do të arrijë kulmin më vonë dhe në nivele më të larta se sa ishte parashikuar më parë.

Projeksionet e reja të OECD-së tregojnë ndikimin e madh dhe global që lufta po ushtron mbi inflacionin, i cili tashmë ka arritur nivelet më të larta të 40 viteve në Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një reduktim gradual i presioneve në zinxhirin e furnizimit dhe çmimeve të mallrave dhe ndikimi i rritjes së normave të interesit duhet të fillojë të ndihet deri në vitin 2023, por inflacioni bazë gjithsesi parashikohet të mbetet në ose mbi objektivat e bankës qendrore në shumë ekonomi të mëdha në fund të vitit.

Kriza e kostos së jetesës do të shkaktojë vështirësi dhe rrezikon urinë

Rusia dhe Ukraina janë furnizues të rëndësishëm në shumë tregje mallrash. Së bashku ata përbëjnë rreth 30% të eksporteve globale të grurit, 20% për misrin, plehrat minerale dhe gazin natyror dhe 11% për naftën. Çmimet për këto mallra u rritën ndjeshëm pas fillimit të luftës.

Mungesa e veprimit, shfaq rrezikun e lartë të një krize ushqimore. Ndërprerjet e furnizimit po rriten, veçanërisht duke kërcënuar vendet me të ardhura të ulëta që janë shumë të varura nga Rusia dhe Ukraina për produktet bazë ushqimore. Me buxhetet publike të zgjatura për dy vjet të pandemisë, këto vende mund të luftojnë për të siguruar ushqim dhe energji me tarifa të përballeshme për popullsinë e tyre, duke rrezikuar urinë dhe trazirat sociale.

Rritja e çmimeve të mallrave dhe ndërprerjet e mundshme të prodhimit do të kenë pasoja të rëndësishme. Rritja e mprehtë e çmimeve tashmë po minon fuqinë blerëse, gjë që do t'i detyrojë familjet me të ardhura më të ulëta në mbarë botën të shkurtojnë artikujt e tjerë për të paguar nevojat bazë të energjisë dhe ushqimit.

<https://www.oecd.org/economic-outlook/>

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të tregut të publikuara nga agjencia lokale e sigurimeve – AZOBH, shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Bosnje-Hercegovinë gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 209.81 milionë BAM ose rreth 107.27 milionë euro. Kjo shifër shpreh një rritje prej 9.20% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Vlera e primeve të shkruara bruto të siguruesve që operojnë në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës u rrit me 8.29% duke arritur në 75.04 milionë euro, ndërsa siguruesit në Republikën Serbe të Bosnjës gjeneruan prime me vlerë 32.24 milionë euro, me 11.40% më shumë se një vit më parë.

Në përgjithësi, primet në sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 7.70% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 83.57 milionë euro. Ndërsa primet në tregun e sigurimit të Jetës u rritën me 14.87%, duke arritur në 23.71 milionë euro. Nga nënklasat e Jo-Jetës, vëllimin më të madh të primeve e zinin dy klasa: sigurimi i pronës me 11.54 milionë euro dhe sigurimit motorik me 57,79 milionë euro (Sigurimi Kasko dhe MTPL së bashku).

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të tremujorit të parë të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, në fund të marsit 2022, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit hungarezë arriti në 395.68 miliardë HUF ose rreth 1.07 miliardë euro. Kjo shifër është 9.82% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Biznesi i sigurimeve të Jetës zë 40.99% dhe biznesi i sigurimeve të Jo-Jetës 59.01% të vëllimit total të primeve.

Për sa i përket dëmeve, totali i dëmeve të shkaktuara (duke mbledhur pagesa e dëmeve dhe ndryshimi i rezervave) u rrit me 10.63% në terma vjetorë, duke arritur në 190.36 miliardë HUF. Dëmtimet e shkaktuara nga në kontratat e sigurimit të Jetës arritën në 122.30 miliardë HUF, ndërsa i njëjti tregues për dëmet në kontratat e sigurimit të Jo-Jetës arriti në 68.06 miliardë HUF.

Në fund të muajit mars 2022, në tregun hungarez të sigurimeve ishin 22 sigurues aktive: 4 sigurues të specializuar në sigurimin e Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues të kompozitë (Jetë dhe Jo-Jetë).

KROACI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara në faqen e internetit të Byrosë Kroate të Sigurimeve, vëllimi i primeve të shkruara bruto të siguruesve kroatë në tremujorin e parë të 2022 u rrit me 9.02% në terma vjetorë, duke arritur në 3.54 miliardë HRK ose rreth 468 milionë euro.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 9.86% në vit, duke arritur në 2.71 miliardë HRK ose rreth 358 milionë euro. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës arriti në 834.10 milionë HRK ose 110 milionë euro, duke u rritur me 6.36% krahasuar me janar-mars 2021.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, KNF, gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, tregu polak i sigurimeve siguroi një vëllim total të primeve të shkruara bruto me vlerë 18.14 miliardë PLN ose rreth 3.9 miliardë euro. Kjo shifër shpreh një rritje prej 2.89% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Gjatë tremujorit të parë 2022, dëmet dhe përfitimet e paguara nga siguruesit vendas u rritën me 12.82% duke arritur në 11.53 miliardë PLN ose rreth 2.5 miliardë euro duke shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 6.76% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në 12.89 miliardë PLN ose 2.8 miliardë euro. Sigurimet e Jetës u ulën me 5.54% duke arritur në 5.24 miliardë PLN ose 1.1 miliardë euro.

REPUBLIKA ÇEKE

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara nga Shoqata Çeke e Sigurimeve, CAP, në fund të marsit 2022, vëllimi total i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve për shoqëritë anëtare të CAP arriti vlerën 40.66 miliardë CZK ose rreth 1.66 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 8.53% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto në sigurimet e Jetës u rritën me 4.06% në vit duke arritur në 12.7 miliardë CZK ose rreth 519.10 milionë euro. Përfaqësuesit e CAP theksuan në një deklaratë se "... Numri i përgjithshëm i kontratave të sigurimit të Jetës vazhdon të bjerë. Ka 2.2% më pak vjet, që korrespondon me një rënie prej rreth 109 mijë. Aktualisht kanë mbetur 4,908,000 kontrata aktive", tha Jaroslav Urban, analist i sigurimeve në Shoqatën Çeke të Sigurimeve.

Në sigurimet e Jo-Jetës, rritja e primeve të shkruara u përshpejtua ndjeshëm me rritje prej 10.68% në vit duke arritur në 28 miliardë CZK ose rreth 1.15 miliardë euro.

Sigurimi i automjeteve vazhdon të jetë dominues në sigurimet e Jo-Jetës duke zënë 50% të totalit të sigurimeve të Jo-Jetës. Në sigurimin e automjeteve, vlera e primeve të shkruara arriti në 7.31 miliardë CZK, duke shënuar rritje me 3.82% më shumë se në tremujorin e parë të vitit 2021. Në sigurimin Kasko, primet e shkruara bruto u rritën me 8.50% dhe arritën në 6.72 miliardë CZK.

REPUBLIKA SLLOVAKE

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të tregut të publikuara nga Shoqata Sllovaqe e Sigurimeve, SLASPO në fund të marsit 2022, vëllimi total i primeve të shkruara bruto për shoqëritë e sigurimeve anëtare të shoqatës arriti në 679.52 milionë euro, me një rritje prej 4.18% në vit. Primet e shkruara në sigurimet e Jetës u rritën me 3.46% në vit duke arritur në 259.81 milionë euro. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 4.63% në terma vjetorë duke arritur në 419.71 milionë euro.

RUMANI

<https://asfromania.ro>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Rumani ka publikuar raportin mbi evoluimin e tregut të kapitalit në vitin 2021. Megjithatë, publikimi analizon edhe çështje të ditës sikurse është mënyra se si kanë reaguar tregjet e kapitalit dhe të mallrave në situatën e luftës në Ukrainë.

...

<https://asfromania.ro/ro/a/2418/2022---rapoarte-pia%C8%9B%C4%83-de-capital>

Raporti pasqyron ecurinë e tregut të kapitalit duke vërejtur rritje pothuajse në të gjitha nivelet e tregut vendas të kapitalit për vitin 2021.

Vitin e kaluar, indekset e Bursës së Bukureshtit (BVB) patën zhvillim pozitiv. Indeksi i kësaj burse, BET, që është si pikë referimi për tregun vendas të aksioneve, i cili kap performancën e kompanive më të tregtuara në tregun e rregulluar të BVB, u rrit me më shumë se 33% krahasuar me fundin e 2020.

Vlera totale e tregtuar në Tregun e Rregulluar dhe Sistemin Multilateral të Tregtimit, (*Multilateral Trading System*) arriti në 21.63 miliardë Lei në vitin 2021, me 16% rritje krahasuar me një vit më parë, ndërsa numri i transaksioneve të kryera në BVB u rrit me 55%.

Aksionet mbeten klasa dominuese e aktiveve financiare, duke zënë 57% të vlerës totale të tregtuar në BVB deri më 31 dhjetor 2021. Në tremujorin e katërt të vitit të kaluar, vlera e transaksioneve në letrat me vlerë të qeverisë shfaqti një prirje rritëse krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020, duke shënuar një rritje prej 22%.

Në fund të vitit 2021, kapitalizimi i tregut në Tregun e Rregulluar arriti në 229.08 miliardë Lei, me rreth 48% rritje krahasuar me 31 dhjetor 2020.

Numri i emetuesve që kanë përdorur tregtimin në Sistemin e Tregtisë Shumëpalëshe të administruar nga BVB pa miratimin paraprak të një prospekti nga A.S.F. arriti në 20. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2021, vlera totale e ofertave publike parësore arriti në rreth 210 milionë Lei.

Nicu Marcu, Kryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë shprehet se "... Fakti që gjithnjë e më shumë kompani po kthehen në tregun e kapitalit është një shenjë se ne jemi në rrugën e duhur. Ne po shohim kompani nga një sërë industrish, që po rrisin vëllimin e tregtimit, që do të thotë se tregu i kapitalit ka filluar të bëhet një opsion për financimin e rritjes së kompanive. Ne po shohim një ndryshim të qartë trendi: ndërsa deri vonë bursa kërkonte emetues të rinj, sot emetuesit po vijnë në bursë në numër në rritje".

Gjatë vitit 2021, u autorizuan 28 fonde investimi alternative, që përfaqësonin si subjekte të sapokrijuara, ashtu edhe subjekte të cilave u kërkohet të respektonin legjislativonin. Gjithashtu gjatë vitit 2021 janë regjistruar dy subjekte të reja si administratorë të fondeve të investimeve alternative, kompani që kanë shprehur synimin e tyre për të krijuar fonde alternative të investimeve në kategorinë e kapitalit privat dhe kapitalit sipërmarrës.

SERBI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundit të vitit, të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, tregu serb i sigurimeve e mbylli vitin 2021 me një vëllim total të primeve të shkruara bruto me vlerë 119.40 miliardë RSD ose 1.02 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje prej 8.64% krahasuar me vitin e kaluar.

Sigurimet e Jo-Jetës përbënin 77.30% të totalit të primeve të shkruara bruto me 92.30 miliardë RSD dhe rritje me 10.20% krahasuar me vitin 2020. Në sigurimet e Jo-Jetës 48.95 miliardë RSD ishin prime nga klasat e sigurimeve motorike dhe 23.73 miliardë RSD – ishin prime nga sigurimet e pronës. Sigurimet e Jetës zinin 22.70% të totalit të primeve me një rritje 3.62% krahasuar me vitin 2020, duke arritur në 27.10 miliardë RSD.

Për sa i përket dëmeve të paguara, vlera e përgjithshme ishte 53.72 miliardë RSD ose rreth 457 milionë euro, nga të cilat dy nënklasat e sigurimeve motorike (MTPL dhe sigurimi Kasko) gjeneruan pothuajse 40% të totalit.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al